Jeni 29 vjeç dhe (ende) nuk keni përfunduar studimet për shkencë ekonomike.

Në radhë të parë të vepruarit liberal për ju nënkupton zbatimin e politikave që favorizojnë sipërmarrjen. Parimisht kjo është diçka e mirë. Megjithatë liria e qytetarit dhe respektimi i ligjeve janë më të rëndësishme. Për ju ka rëndësi që gjykatat të kryejnë me seriozitet punën e tyre dhe të respektojnë ligjin pa u bërë pre e dyshimeve për afere korruptive. Para gjykatës të gjithë janë të barabartë.

Po kaq e rëndësishme për ju është trajtimi i barabartë i burrave dhe grave; liria e shtypit dhe e mendimit zënë vend të rëndësishëm në botëkuptimin tuaj. Ndryshe nga këto parime liria e besimit fetar dhe liria që çdo qytetar të ketë mundësi të zgjedhë fenë sipas gjykimit të vet janë më pak të rëndësishme. Edhe karshi ateistëve nuk keni ndonjë rezervë. Në pikëpamjen tuaj feja nuk duhet të luajë rol në shtet. Veç kësaj ju besoni në lirinë e bashkëjetesës, pa qenë të nevojshme lidhjet martesore.

Ju angazhoheni publikisht për këto të drejta. Kjo ka qenë dhe arsyeja pse jeni anëtarësuar në këtë parti, e cila si forcë relativisht e re politike ka ende shumë alternativa që mund të shfrytëzohen. Interesat e qytetarëve lidhen me liritë e tyre individuale, të cilat duhen mbrojtur. Veç kësaj duhet të rritet shkalla e ndërgjegjësimit në lidhje me faktin se duhet luftuar politikisht për të fituar liri dhe të drejta të mëtejshme për shoqërinë.

Jeni i mendimit se parimet e ekonomisë së lirë të tregut nuk përbëjnë arsye për të cunguar të drejtat e njeriut. Jeni i ndërgjegjshëm se për të bërë koalicion duhet të bëni kompromise. Por për ju, për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut nuk mund të bëhet asnjë lëshim. Ju përpiqeni fort që të bindni për këtë edhe politikanë të tjerë.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjedhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli CC 5

Jeni 40 vjeç dhe punoni si redaktor në një gazetë.

Për ju ka rëndësi thelbësore që gjykatat të jenë të drejta dhe të mos kenë lidhje me korrupsionin. Para gjykatës të gjithë njerëzit janë të barabartë. Po kështu për ju është e rëndësishme që burrat dhe gratë në profesionin tuaj të trajtohen njësoj. Ju respektoni dhe mbështesni lirinë e shtypit dhe angazhoheni që çdokush të jetë i lirë në shprehjen e mendimit. Veç kësaj ju besoni në lirinë e bashkëjetesës, pa qenë të nevojshme lidhjet martesore.

Në radhë të parë të vepruarit liberal për ju nënkupton zbatimin e politikave që favorizojnë sipërmarrjen. Parimisht kjo është diçka e mirë. Megjithatë liria e qytetarit dhe respektimi i ligjeve janë më të rëndësishme. Ju angazhoheni publikisht për këto të drejta. Kjo ka qenë dhe arsyeja pse jeni anëtarësuar në këtë parti. Për fat të keq vëreni se zhvillimet brenda partisë tuaj po shkojnë gjithnjë e më shumë në tjetër drejtim, gjë që nuk ju pëlqen aspak. Pasi janë pikërisht qëndrimet e paraqitura më lart, ato që ju përfaqësoni brenda dhe jashtë partisë.

Jeni i mendimit se parimet e ekonomisë së lirë të tregut nuk përbëjnë arsye për të cunguar të drejtat e njeriut. Jeni i ndërgjegjshëm se për të bërë koalicion duhet të bëni kompromise. Por duke qenë se për ju, çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut nuk janë të negociueshme, jeni skeptik sa i takon kompromiseve. Nëse brenda partisë nuk do të bihet dakord, mund të mos jeni më anëtar i saj. Bisedat e zhvilluara në drejtime të ndryshme mund t'ju ndihmojnë për të marrë vendimin përfundimtar.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Grupi i partisë DD

Partia juaj është krijuar para pak kohësh dhe është shumë moderne. Suksesi i deritanishëm ju jep të drejtë. Në pamje të parë kjo bie në sy për shembull në faktin se partia juaj mbledh në radhët e saj njerëz të interesuar politikisht nga të gjitha grupet dhe shtresat shoqërore. Ndryshe nga partitë e tjera, pakicat kanë mundësi të mira për të kontribuar në politikat e partisë dhe për të bashkëvendosur.

Tashmë ka ardhur çasti për të shfrytëzuar situatën politike për të dhënë prova për qëllimet e mira të partisë dhe për besueshmërinë e saj. Anëtarët e partisë kanë vendosur për secilin personalisht se lufta për të drejtat e pakicave etnike nuk duhet të dështojë për shkak të pengesave artificiale të partive apo të përfundojë për shkak të tyre. Ky është një qëndrim parimor dhe i panegociueshëm i partisë tuaj. „Tradita jonë kapërcen kufijtë“ është motoja juaj më e rëndësishme. Ndaj nuk është aspak për t'u habitur, se përse gjatë zgjedhjeve të fundit, partia juaj pati shumë popullaritet në radhët e zgjedhësve.

Pavarësisht qëndrimeve të tjera, partia juaj nuk përfaqëson vetëm interesat e veçanta të një grupi në vend; kjo nuk është thjesht strategji për të mos u instrumentalizuar politikisht. Ju jeni të mendimit, se objektivi kryesor duhet të jetë trajtimi i barabartë i të gjitha grupeve etnike e fetare. Në të shkuarën në vendin tuaj janë diskriminuar sidomos grupet e vogla etnike dhe fetare, pjesërisht ndaj tyre ende nuk tregohet interesi dhe kujdesi i duhur. Partia juaj synon të jetë një fortesë kundër diskriminimit të pakicave, pasi e keni të qartë se kjo mund të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Rritja ekonomike përbën një element kyç të politikave tuaja, por nuk mbështesni ndonjë sektor të caktuar.

Një tjetër aspekt përbën dhe synimi për t'u dhënë sërish perspektivë njerëzve që jetojnë jashtë kryeqytetit, pasi në zonat rurale, veçanërisht në zonat më të thella kufitare ende jetojnë pjesa më e madhe e pakicave. Pikërisht këtu duhet të fillojë dhe të mbështetet në mënyrë veçantë zhvillimi, pasi kjo është rruga e vetme për të ndaluar lëvizjet migratore drejt kryeqytetit. Partia juaj angazhohet edhe për mbrojtjen e pakicave në shtetet fqinjë. Po kështu ju jeni pro pranimit të refugjatëve.

Nga sa u tha më lart, duket qartë se partia juaj mbështet njerëzit e marginalizuar dhe të diskriminuar dhe synon të rrëzojë barrierat sociale. Po kështu ju angazhoheni për një strategji, e cila parashikon forcimin e të drejtave dhe të rritjes së mundësive të pjesëmarrjes së pakicave në nivel vendor. Në këtë kontekst aksesit në fondet publike konsiderohet si motor për riorganizimin e strukturave sociale si dhe për t'u dhënë impulse atyre që presin në mënyrë pasive mundësi për zhvillim të mëtejshëm. Në plan të parë qëndron lufta ndaj diskriminimit.

Për të ushtruar ndikim politik, për partinë tuaj (ende) të vogël është e rëndësishme të hyjë në koalicion me forca të tjera politike. Pa dyshim kjo do të thotë se duhet të bëni kompromise, çka nuk është krejt e lehtë, pasi jeni një parti ende e pakonsoliduar dhe në kërkim të profilit politik. Diskutoni rreth qëndrimeve themelore të partisë suaj dhe identifikoni fushat, në të cilat do të ishit të gatshëm të bëni lëshime.

Roli DD 1

Jeni 44 vjeç dhe keni pozicion drejtues në një fabrikë këpucësh.

Burrat dhe gratë janë të barabartë, pavarësisht etnisë apo fesë.

Ky pohim është element thelbësor i gjithë veprimtarisë tuaj politike. Në të shkuarën e keni përjetuar nga afër diskriminimin. Ju respektoni rregullat e bashkësive të ndryshme, por kërkoni të gjeni edhe një bazë të përbashkët, të cilën mund ta respektojnë njësoj të gjitha bashkësitë a grupimet e ndryshme. Ju kërkoni të arrihet „një marrëveshje shoqërore“, e cila krijon barazi të përhershme.

E thënë ndryshe, ju merreni intensivisht me të ardhmen e kryeqytetit. Qëllimi juaj është të ndërtoni në Europë një qytet pa diskriminime. Kusht për përmbushjen e këtij qëllimi, është eliminimi i traditave dhe varësive të vjetra, që përmbajnë elementë të papërputhshëm.

Veç kësaj ju përfaqësoni qëndrimin se të gjitha pozicionet e punës duhet të jenë të hapura për të gjithë. Qeveria jo vetëm që duhet të respektojë lirinë gjuhësore të banorëve, por dhe ta mbështesë atë. Në rininë tuaj keni përjetuar nga afër një regjim ateist, ndaj dhe angazhoheni me forcë për lirinë e fesë, e cila mbështet veçanërisht ushtrimin aktiv të besimit fetar. Në këtë kuptim duhet të merren në konsideratë edhe festat fetare të besimeve të ndryshme. Në lidhje me çështje të tjera jeni më fleksibël dhe më i gatshëm për kompromise sesa në lidhje me pikat e mësipërme.

E keni të qartë se kompromiset janë të nevojshme, por jo me çdo çmim. Identifikoni kufijtë tuaj, deri ku jeni i gatshëm të bëni lëshime.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli DD 2

Jeni 50 vjeç dhe punoni në sektorin e shërbimit në një restorant.

Burrat dhe gratë janë të barabartë, pavarësisht etnisë apo fesë.

Ky pohim është element thelbësor i gjithë veprimtarisë tuaj politike. Ju respektoni rregullat e bashkësive të ndryshme, por kërkoni të gjeni edhe një bazë të përbashkët, të cilën mund ta respektojnë njësoj të gjitha bashkësitë a grupimet e ndryshme. Ju kërkoni të arrihet „një marrëveshje shoqërore“, e cila krijon barazi të përhershme për të gjithë njerëzit në BON-NIELAND. Thënë ndryshe, ju merreni intensivisht me të ardhmen e kryeqytetit. Qëllimi juaj është ta bëni FUTURAN një kryeqytet pa diskriminime. Kusht për përmbushjen e këtij qëllimi, është eliminimi i traditave dhe varësive të vjetra, që përmbajnë elementë të papërputhshëm.

Barazia gjinore ka rëndësi të veçantë për ju. Drejtësia mund të arrihet vetëm, nëse burrat dhe gratë trajtohen vërtet në mënyrë të barabartë. Por trajtimi i kësaj teme nuk mbetet krejt pa kontradikta. Vendi ka ende punë për të bërë në fushën e barazisë gjinore. Ka raste të aborteve selektive për shkak të gjinisë, çka është shumë shqetësuese. Qeveria jo vetëm që duhet të respektojë larminë dhe ndryshimet e popullatës, por dhe duhet ta mbështesë atë. Në këtë kontekst duhen të merren parasysh edhe praktikat fetare të besimeve të ndryshme.

Jeni i bindur se kompromiset janë të paevitueshme, kur vjen puna për gjetjen e alternativave të sukseshme të veprimit. Identifikoni se deri në ç’pikë partia është e gatshme të bëjë lëshime dhe çfarë mundësisht krijon kjo sipas rastit për ju.

Por mos harroni parimet tuaja.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli DD 3

Jeni student, 25 vjeç, shumë i interesuar për politikën.

Keni kuptuar se burrat dhe gratë janë të barabartë, pavarësisht etnisë, identitetit seksual apo fesë. Ky pohim është element thelbësor i gjithë veprimtarisë tuaj politike. Megjithatë angazhoheni në radhë të parë për të drejtat e grupeve që kanë themeluar partinë ku bëni pjesë. Nëse grupet e tjera etnike duan të respektohen më shumë, atëherë duhet të formojnë partitë e veta, të cilat angazhohen për çështjet e tyre. Ka mbaruar koha, kur ju shqetësoheshit për interesat e grupeve të tjera etnike. Tashmë bëhet fjalë për të drejtat e njerëzve tuaj që kanë qenë gjithmonë të papërkrahur. As grupet e tjera nuk e kanë vrarë shumë mendjen për gjendjen tuaj gjatë dekadave të fundit. Perspektiva e punësimit në BONNIELAND nuk është hiç premtuese për të rinjtë. Edhe kjo është një çështje që doni ta përmirësoni. Keni marrë pjesë edhe në demonstrata e protesta për një botë më të drejtë.

Tani ka ardhur koha që të qeverisni. Mendoni se është e kotë të vrisni mendjen për gjëra të tjera. Por kjo nuk mund të arrihet pa bërë lëshime. Këtë e keni të qartë dhe e mbronni me bindje.

Tregohuni i guximshëm dhe përpiquni të ndiqni të gjitha kërkesat që ju janë paraqitur si dhe t'i realizoni ato.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli DD 4

Jeni rreth të dyzetave, i papunë dhe i angazhuar politikisht në fusha të ndryshme politike. Keni kohë të mjaftueshme. Burrat dhe gratë janë të barabartë, pavarësisht etnisë apo fesë.

Ky pohim është element thelbësor i gjithë veprimtarisë tuaj politike. Megjithatë në radhë të parë ju angazhoheni për të drejtat e grupit etnik që ka themeluar partinë.

Nëse grupet e tjera etnike duan të respektohen më shumë, atëherë duhet të formojnë partitë e veta, të cilat angazhohen për çështjet e tyre. Ka mbaruar koha, kur ju shqetësoheshit për interesat e grupeve të tjera etnike. Tashmë bëhet fjalë për të drejtat e njerëzve tuaj që kanë qenë gjithmonë të papërkrahur. Për këtë qëllim jeni i gatshëm të bëni shumë. Idetë revolucionare të rinisë vazhdojnë të jenë pjesë e juaj.

E keni të qartë se bashkëpunimet me partitë e tjera politike mund të realizohen vetëm nëse jeni i gatshëm të bëni lëshime. Por ju kundërshtoni fort idenë e lëshimeve dhe kompromiseve pas zgjedhjeve.

Jeni gati të pranoni kompromise të vogla, por pa ndryshuar profilin e partisë tuaj. Mos e harroni këtë qëndrim, pasi disa prej kolegëve të partisë tuaj janë shumë të tërhequr në këtë drejtim.

Luftoni për çështjet e lëvizjes tuaj politike. A jeni i bindur se politika juaj është politika e duhur për të ardhmen?

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli DD 5

Jeni 34 vjeç punoni si mësues.

Të drejtat e pakicave mund të realizohen siç duhet, vetëm nëse i voton shumica. Kjo është bindja juaj. Ndaj duhet të tregoheni i kujdesshëm që nga të drejtat e pakicave të mos lindin pakica të tjera. Jeni plotësisht i ndërgjegjshëm rreth konstruktit të brishtë pakicë – shumicë.

Gjatë zgjedhjeve të fundit forca juaj politike arriti të merrte vota të konsiderueshme. Tashmë në kuadër të klimës aktuale politike duhet të bëni politikë të arsyeshme për të vazhduar në rrugën e suksesit. Kjo do të thotë që nuk mund të vazhdoni të rrisni nivelin e pretendimeve tuaja – për të gjitha çështjet. Duhet të argumentoni bindshëm, në mënyrë që partitë e tjera politike të kuptojnë se kërkesat tuaja janë të drejta e të justifikueshme. Sistemi pluralist i partive politike është argumenti juaj thelbësor për BONNIELAND-in dhe ju e përdorni si mjet propagande politike. Partia juaj nuk është parti proteste dhe as parti që „përfaqëson vetëm një çështje”. Në radhët tuaja ka ekspertë të ekonomisë e të mjedisit. Edhe ky është fakt që ju pëlqen ta vini gjithnjë në dukje. Të gjitha kahet politike e konsiderojnë partinë tuaj si një partner të besueshëm koalicioni. Për ju do të ishte krejt i pranueshëm edhe një koalicion i përbërë nga tri parti të vogla. Ju propozoni të formohet një koalicion politik i drejtuar nga përfaqësuesi i një prej minoriteteve. Ky do të ishte një mesazh i mirë për opinionin publik. Ju vetë i përkisni një minoriteti.

Brenda partisë jeni personi i kontaktit për „grupin e interesit të bashkësive fetare“. Keni interesa të përbashkëta që shërbejnë si bazë e mirë për bashkëpunim.

Jeni i mendimit se edhe shumicat kanë ç'të mësojnë nga pakicat.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Grupi i partisë EE

Grupi EE është pjesë e një lëvizjeje qytetare të FUTURA-s dhe disa qyteteve të tjera të BONNIELAND-it. Për një kohë të gjatë për FUTURA-n ka pasur rol shumë të rëndësishëm industrializimi, por jo shqetësimet e njerëzve që punonin në këto sektorë dhe që vuanin pasojat e industrializimit për ujin, ajrin dhe tokën. Sot shumica dërrmuese e produkteve bujqësore duhet të sillen nga zona të largëta apo të importohen nga vende të tjera.

Gjatë viteve të shkuara anëtarët e grupit EE kanë bashkëpunuar me grupime të shoqërisë civile, qëndrimet e të cilave janë shumë më radikale se qëndrimet aktuale të partisë tuaj. Gjatë fushatave zgjedhore të viteve të fundit grupimet radikale janë shkëputur një pas një nga partia EE. Në disa zgjedhje madje këto grupe kanë arritur të marrin vota nga një pjesë e zgjedhësve të partisë EE. Por partia juaj nuk bën propagandë politike me slogane si “Të kthehemi në epokën e gurit!”. Përkundrazi qëllimi juaj është transformimi drejt një të ardhmeje të gjelbër që përdor energjinë diellore. Në këtë pikë ju keni qëndrime të qarta në mbështetje të industrisë dhe investimeve. Deri tani partia EE nuk ka pasur mundësi t’i integrojë idetë e saj në ndonjë koalicion partiak në nivel vendor. Gjatë fushatës së fundit zgjedhore u diskutua mundësia e koalicionit me partinë BB, por disa anëtarë të grupit EE kishin rezerva të shumta në lidhje me “transformimin industrial” dhe mbështetjen më tepër koalicionin me partinë AA ose CC. Gjithsesi shumica e anëtarëve të partisë EE nuk kanë ndonjë kundërshti të madhe parimore me grupin DD.

Një prej kërkesave themelore është renatyralizimi i lumit të qytetit FUTURA dhe ndalimi i ndërtimeve dhe i betonizimit të bregut të lumit. Veç kësaj duhet të krijohet lidhja e qendrës së qytetit me pyllin. Qyteti FUTURA duhet të mbështetet në burimet e rinovueshme të enegjisë dhe të përdorë erën dhe ujin si burime energjetike. Po kështu panelet diellore mund të përdoren më së miri në qytetin tuaj.

Të tjera kërkesa të rëndësishme janë gjetja e zgjidhjeve për zonën industriale dhe fabrikat e saj të vjetra si dhe angazhimi që qytetarët të kenë mundësi t’i parashtrojnë shqetësimet e tyre në këshill bashkiak në mënyrë më direkte. Disa prej anëtarëve të partisë EE e konsiderojnë këtë edhe si zgjidhje për t’i dhënë fund kontradiktave mes forcave politike duke krijuar më në fund një qeverisje të qëndrueshme vendore.

Vetë forca juaj politike shprehet se është e hapur për të gjitha grupet etnike dhe fetare. Po kështu ajo mbështet fuqimisht integrimin dhe emigrimin. Ardhja e njerëzve nga vendet fqinjë konsiderohet më tepër si mundësi sesa si rrezik. Një tjetër parim i partisë tuaj është: „Së bashku dhe jo kundër njëri-tjetrit!“.

Roli EE 1

Jeni afër të dyzetave dhe tregtoni ushqime të shëndetshme që prodhohen kryesisht brenda vendit.

Keni lindur dhe jeni rritur në fshat, rreth 50 km në lindje të kryeqytetit. Pas vdekjes së babait keni trashëguar fermën e familjes, ku kaloni shpesh fundjavat. Familja ka pasur mundësi t'ju dërgojë me studime jashtë vendit, ku keni mbaruar studimet për shkencë natyrore.

Pas studimeve jeni kthyer në vendin tuaj dhe jetoni bashkë me familjen në kryeqytet. Gjatë studimeve keni pasur lidhje të ngushta me lëvizjen ekologjike „Rrënjët e barit“, qëllimet e të cilës luajnë rol të rëndësishëm për ju sot e kësaj dite. Për ju është krejt e qartë se „hapësira jetike: natyra“ e vendit tuaj është pre e shkatërrimit të vazhdueshëm. Ju vëreni vazhdimisht asgjësimin e pandalshëm të natyrës, konsumin e tepruar të njerëzve dhe radikalizimin e popullsisë. Por parimisht nuk jeni kundër investimeve. „Natyra si bazë e jetës duhet të mbrohet me çdo mjet“, kjo është një prej thënieve tuaja të njohura për publikun.

Po kështu në përgjithësi nuk jeni kundër industrisë. Ju kërkoni që të jetë më e dukshme tendenca për më shumë qëndrueshmëri. Burimet natyrore duhet të ruhen e përdoren me kujdes. Këto janë gjërat për të cilat angazhoheni dhe jeni i gatshëm të luftoni. Kur vjen puna për këto çështje nuk jeni hiç i gatshëm të bëni lëshime.

Vëreni me kënaqësi ndryshimin e kursit politik që po bëhet gjithnjë e më i dukshëm në qytetin e FUTURA-s. Mendoni se mund të kandidoni për postin e kryetarit të bashkisë.

Miqtë tuaj i konsiderojnë qëndrimet tuaja politike si radikale.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjedhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli EE 2

Jeni 28 vjeç dhe një prej anëtarëve të rinj të partisë. Punoni në një kompani IT në nivel drejtues. Shkallët e karrierës në parti i keni ngjitur shpejt. Keni jetuar gjatë gjithë jetës në BONNIELAND dhe i njihni mirë strukturat politike të vendit tuaj. Njerëzit që interesohen për çështje ekologjike dhe mjedisore ende konsiderohen si qenie ekzotike. Por këtë e keni të qartë. Po kështu e dini mirë se ka pak gjasa që pretendimet radikale të të gjelbërve të vihen të jetë. Ndryshimet kanë nevojë për kohë të gjatë. Ndonjëherë edhe hapat e vegjël përpara mund të jenë një sukses i madh. Për ju është e rëndësishme që njerëzit të kuptojnë sesa të rëndësishme janë çështjet ekologjike dhe mjedisore. Ndaj dhe angazhoheni për energjitë e rinovueshme; pikësëpari për të shfrytëzuar burimet detare, me qëllim forcimin ekonomik dhe ritjen e qëndrueshmërisë.

Për fat të keq ndryshime të tilla kushtojnë shtrenjtë. Megjithatë jeni i bindur se mbrojtja e mjedisit është e vetmja rrugë e duhur drejt së ardhmes. Më e rëndësishmja nuk është të jesh anëtar i qeverisë, mjedisi është gjëja më e rëndësishme. Ju angazhoheni për idealet tuaja, jo si një luftëtar i zhurmshëm, por me qetësi dhe bindje në qëllimet tuaja.

Mos u dorëzoni dhe luftoni për qëllimet tuaja. Kjo nuk është beteja e parë e jetës suaj. Deri tani ia keni dalë mbanë t'i bindni të tjerët për idetë tuaja...

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Roli EE 3

Jeni 63 vjeç dhe i papunë.

E doni vendin tuaj, ku jetoni prej më shumë se 60 vjetësh. Mendoni se politika e partive që kanë qeverisur gjatë 20 viteve të fundit nuk ka sjellë asnjë dobi. Niveli i papunësisë është i lartë. Standartet sociale në vend janë ende të ulëta dhe populli është i neveritur nga politika. Veç këtyre edhe gjendja e ndërmarrjeve industriale ka efekte negative për mjedisin dhe shëndetin.

Kjo situatë nuk mund të vazhdojë më kështu. E megjithatë ju e doni vendin tuaj dhe jeni krenar për historinë e lavdishme të shekujve të fundit. Po kështu jeni krenar për faktin që njerëzit kanë bashkëjetuar në paqe me njëri-tjetrin. Qëllimi juaj është të jeni pjesë e një vendi të fortë e të suksesshëm ekonomikisht. Në këtë kontekst për ju ka rëndësi thelbësore një mjedis, ku qytetarët e BONNIELAND-it të jetojnë të shëndetshëm. Kush e do vendlindjen, e mbron atë. Ndaj dhe keni qëndrim skeptik karshi privatizimeve të pakontrolluara. Jeni i mendimit se ky është një prej burimeve kryesore të korrupsionit. Motoja juaj është: “Të menduarit për zhvillim të qëndrueshëm nuk na lejon të harrojmë të nesërmen”.

“Politika e shëndetshme” nuk mbron vetëm kombin, por edhe qytetarët. Ju angazhoheni për të dyja dhe jeni i ndërgjegjshëm se ndryshimi i situatës mund të arrihet vetëm nëpërmjet kompromiseve, përndryshe është e vështirë të arrihet shumica. Për këto arsye ju diskutoni shumë me të tjerët, sidomos me ata që nuk ndajnë të njëjtat qëndrime, pasi doni të kuptoni sesa të gatshëm janë për të bërë kompromise.

Ju doni të hartoni strategji dhe të bëni politika, jeni i gatshëm të bëni kompromiset e nevojshme, ndaj dhe përpiqeni të bindni për këtë edhe kolegët tuaj.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjedhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

EE 4

Jeni 54 vjeç, me profesion vrojtues plazhi.

E njihni mirë jetën politike, pasi prej 20 vjetësh jeni i angazhuar aktivisht në politikë, prej 10 vjetësh punoni për qëllimet e partisë suaj. Për ju ka rëndësi themelore që të jeni anëtar i koalicionit në këshillin bashkiak të qytetit. Vetëm kush ka shumicën, mund të qeverisë dhe t'i japë formë zhvillimit nëpërmjet nismave dhe vendimeve. Në pikëpamjen tuaj opozita është thjesht vëzhguese, pa aftësi formësuese apo pa fuqi për të sjellë zhvillim në qytet. Të bësh kompromise do të thotë të japësh e të marrësh. Pavarësisht kësaj, parimet themelore të partisë suaj nuk janë të negociueshme!

Parime të tilla bazë janë te drejtat e gruas, të pakicave, mbrojtja e mjedisit dhe bashkëjetesa paqësore. Realizimi i këtyre qëllimeve do të sjellë një të ardhme të ndritur për vendin. Por shpesh ndodh që hapat e parë e të vegjël janë më lehtë për t'u hedhur se reformat rrënjësore të gjithanshme. Ndaj për arritjen e qëllimeve tuaja politike ju veproni me këmbë në tokë. Në planin afatgjatë mendoni se strategjia më efektive është përmbyshja graduale e objektivave.

Ju mbështesni „grupin e interesit për mjedisin“ dhe keni kontakte me ta.

Përpiquni t'i zgjasni dorën për bashkëpunim grupit, i cili angazhohet për pakicat. Jeni i mendimit se këtu janë kushtet më të mira për një bashkëpunim të suksesshëm.

Detyrat:

Gjatë seancës së parë të grupit të partisë suaj duhet të zgjidhni një zëdhënës të grupit. Gjatë bisedimeve ky person ka për detyrë thirrjen e mbledhjeve në një kohë të shkurtër, në mënyrë që më vonë të zhvillojë bisedime me grupet e tjera dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit. Ai shërben dhe si person kontakti për marrëdhëniet me shtypin.

Së dyti duhet të gjeni një emër domethënës për grupin tuaj (përdorni shkurtime dhe lëreni të lirë imagjinatën). Gjetja e emrit është një aspekt i rëndësishëm, duke qenë se mund të shpalosë aspekte të programit politik të partisë tuaj.

Më pas hapi më i rëndësishëm është të hartoni programin e partisë tuaj duke përmendur objektivat për të ardhmen. Programi do të prezantohet në plenum.

Detyra për një fazë të mëvonshme:

Pas prezantimit të të gjitha partive / grupeve diskutoni në grup për partnerët e mundshëm për koalicion (grupimet e tjera partiake), me të cilët mendoni se mund të bashkëpunoni në këshillin bashkiak.

Zgjedhjet e reja do të zhvillohen së shpejti dhe për gjashtë muajt e mbetur duhet të zgjidhet edhe kryetari ri i bashkisë. Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë nuk mjafton shumica e thjeshtë. Vendimi i grupit tuaj partiak do të jetë një sinjal i qartë për zgjedhjet e ardhshme.

Për këtë qëllim duhet të krahasoni konkretisht planet, konceptet dhe objektivat e grupeve të tjera partiake. Hartoni një listë me argumente pro dhe kundër bashkëpunimit të mundshëm me to; mos harroni të votoni brenda grupit tuaj se ç'qëndrim konkret do të mbani për një temë të caktuar dhe cilat janë temat më të rëndësishme për ju.

Në këtë proces mos e nënvlerësoni aspak fuqinë dhe ndikimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Ata vërtet nuk janë anëtarë të Këshillit Bashkiak, por përfaqësojnë grupe të rëndësishme të qytetarëve të bashkisë tuaj.

Vetëm pas përfundimit me sukses të bisedimeve dhe negociatave për krijimin e koalicionit mund të parashtroni në këshill propozimet për zgjidhjen e problemeve apo për konceptimin e së ardhmes.

Veç kësaj çështja tjetër që shtrohet për diskutim është se cili prej anëtarëve të koalicionit është personi i duhur për t'u zgjedhur në postin e kryetarit të bashkisë, me qëllim që ai të zgjidhet me votat e shumicës së koalicionit.

Hartoni strategji të mëtejshme për të nisur procesin e bisedimeve me grupet e tjera. Strategjitë duhet të përfshijnë edhe udhëzimet përkatëse për zëdhënësin (kryetarin) e grupit në lidhje me mënyrën sesi ky i fundit duhet të informojë anëtarët e tjerë të grupit.

Grupi i shtypit

Kudo në botë është e dukshme se mediat luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për politikën. Të dyja fushat janë lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, pavarësisht nëse bëhet fjalë për mediat klasike të shtypit të printuar apo variantet e tyre elektronike, radion, televizionin apo internetin. Për ta bërë të qartë rëndësinë e mediave në ditët e sotme ato quhen dhe „pushteti i katërt“ i sistemeve politike.

Këto tendenca janë të dukshme edhe në BONNIELAND. Në radhë të parë puna e mediave përqendrohet në përcjelljen e informacioneve strategjike dhe paraqitjen e reportazheve specifike që i drejtohen grupeve të synuara.

Aftësia e mediave për të ndikuar mendimin dhe mentalitetin e opinionit publik pikësëpari ka të bëjë me faktin se ato janë të gjithëpranishme. Në këtë kuptim, mediat kanë një funksion të rëndësishëm në sistemet demokratike: ato bëjnë të mundur që të arrihet transparencja e nevojshme e sistemit politik. E parë nga një këndvështrim tjetër, mediat ushtrojnë ndikim jo vetëm mbi opinionin publik, por paraqesin edhe efektet e vendimeve politike. Në këtë kuptim fuqia „politike“ e mediave rritet pa qenë e legjitimuar në struktura të Bashkisë si një A-neta I Bashkisë, duke bërë që protagonistët e vërtetë ndonjëherë të mos dalin në plan të parë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, përfaqësues të mediave të BONNIELAND-it!

Në të ardhmen e afërt do jetë e nevojshme të merren një sërë vendimesh të rëndësishme e më pak të rëndësishme për të ardhmen e vendit tuaj, veçanërisht në kryeqytet. Politika e deritanishme e qeverisë nuk është më e qëndrueshme. Ka disa tregues të dukshëm por dhe shenja të tjera që reflektojnë rritjen e potencialit konfliktual, të cilat së bashku të bëjnë të mendosh se do të ketë rotacion të pushtetit.

Kryeredaktori ju ja ngarkuar detyrën e realizimit të një fushate informimi. Mendoni se ka ardhur çasti i duhur për të rigjallëruar lexuesit e gazetës tuaj. Në këtë proces, detyra juaj është të hidhni dritë mbi proceset aktuale në vend, t'i prezantoni opinionit publik zhvillimet politike dhe shoqërore si dhe të nxisni qytetarët e BONNIELAND-it të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme. Detyra juaj kryesore është të paraqisni me transparencë; jo vetëm duke përcjellë informacione të përgjithshme, por edhe duke paraqitur detaje rreth partive dhe politikanëve.

Ndani detyrat e ndryshme brenda ekipit tuaj; hartoni një plan kohor, për të qenë në kohën e duhur në vendin e duhur. Ka shumë gjasa që të duhet të jeni në vende të ndryshme, por mos harroni që herë pas here të ktheheni në zyrën tuaj, t'u raportoni kolegëve dhe të shkruani artikujt tuaj.

Kini gjithnjë parasysh se reportazhet, pyetjet dhe artikujt tuaj, madje dhe thjesht prania juaj mund të influencojë vendimmarrësit dhe rrjedhimisht - dashur pa dashur - mund të ketë efekte mbi zhvillimet politike. Tregohuni i ndërgjegjshëm për këtë përgjegjësi.

Si gazetarë me përvojë mund të konceptoni strategji të ndryshme, të merrni dhe të përcillni informacione. Mbani parasysh tipet e ndryshëm të lexuesve tuaj dhe përpiquni të realizoni një fushatë informimi gjithëpërfshirëse!

Suksese në punën tuaj!

Redaksia

Roli i parë – Shtypi

Jeni gazetar i gazetës më të vogël në vend. Gazeta juaj dikur është themeluar nga një prej pakicave etnike, ndaj dhe i drejtohet kryesisht këtij spektri lexuesish. Edhe pse kjo do të nënkuptonte përjashtimin e pakicave të tjera etnike apo fetare, në gazetën tuaj ju përpiqeni t'u kushtoni vëmendje të gjitha pakicave të BONNIELAND-it.

Detyrat:

- Përpiquni të jeni vazhdimisht në kontakt me politikanët, sidomos me ata që janë të hapur karshi çështjeve që lidhen me pakicat.
- Informoni opinionin publik rreth projekteve dhe zhvillimeve të fundit.
- Publikoni sistematikisht shkrime dhe opinione rreth zhvillimeve politike.

Detyra të tjera:

- Përpiquni të ndiqni diskutimet rreth koalicioneve të mundshme dhe planeve të ardhshme, ose sipas mundësisë të jeni i pranishëm gjatë bisedimeve.
- Përpiquni të realizoni sa më shumë biseda individuale.

Roli i dytë – Shtypi

E përditshmja, për të cilën punoni, është gazeta më e vjetër në vend me një traditë të hershme e themeluar qysh në kohën, kur BONNIELAND ende nuk kishte fituar pavarësinë. Që nga kjo kohë nuk ka ndryshuar vetëm ekipi i redaksisë tuaj, por edhe lexuesit. Sot ju i drejtoheni kryesisht publikut intelektual si dhe shtresave të arsimuara që janë pjesë e sistemit arsimor. Shumë prej analistëve që shkruajnë për gazetën tuaj, japin mësim në universitete apo vijnë nga radhët e shkencës.

Synimi juaj është të kuptoni motivet e politikëbërjes (Policy-Making), pra të analizoni pyetjen sesi bëhet politikë. Ndaj keni kontakte të vashdushme me politikanët dhe përfaqësuesit e qeverisë. Edhe pse synoni të bëni gazetari elitare, përpiqeni të fitoni sa më shumë lexues.

Detyrat:

- Përpiquni të jeni vazhdimisht në kontakt me politikanët.
- Informoni opinionin publik rreth projekteve dhe zhvillimeve të fundit.
- Publikoni sistematikisht shkrime dhe opinione rreth zhvillimeve politike.

Detyra të tjera:

- Përpiquni të ndiqni diskutimet rreth koalicioneve të mundshme dhe planeve të ardhshme, ose sipas mundësisë të jeni i pranishëm gjatë bisedimeve.
- Përpiquni të realizoni sa më shumë biseda individuale.

Roli i tretë – Shtypi

Punoni për gazetën më të madhe në vend. Gazeta juaj është një gazetë e pavarur edhe pse disa prej pronarëve kanë lidhje direkte me politikën dhe marrëdhënie të ngushta me anëtarët e qeverisë. Përbërja e lexuesve tuaj është e larmishme, që nga njerëzit e mirar-simuar deri tek shtresat më pak të shkolluara. Për këtë arsye stili i shkrimeve dhe strategjia juaj e komunikimit duhet të jetë të lehta për t'u kuptuar.

Synimi juaj është informoni qytetarët vazhdimisht rreth aktualitetit. Eksperimentet janë të rrezikshme dhe shpesh të “importuara” nga vendet e tjera. Sigurohuni që shkrimet tuaja i përshtaten popullsisë së vendit.

Detyrat:

- Përpiquni të jeni vazhdimisht në kontakt me politikanët.
- Informoni opinionin publik rreth aktualitetit
- Publikoni sistematikisht sllogane.

Detyra të tjera:

- Përpiquni të ndiqni diskutimet rreth koalicioneve të mundshme ose sipas mundësisë të jeni i pranishëm gjatë bisedimeve.
- Përpiquni të realizoni sa më shumë biseda individuale.
- Mbani lidhjet me qeverinë “e vjetër” për të shmangur kontradiktat.

Fjala e anëtarërit më të vjetër të Këshillit Bashkiak

Të dashur kolegë!

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Përfaqësues të mediave!

Qyteti ynë ka pas vetes një histori të lavdishme! E po kështu edhe kohë tepër të vështira! Kemi arritur të kapërcejmë diktaturën komuniste dhe të mbledhim përvoja si kryeqytet i një vendi të lirë e të pavarur. Kemi ndërtuar një sistem demokratik. Kjo është „qeveria e popullit, e zgjedhur nga populli për popullin“! Të mos harrojmë asnjëherë, se ndodhemi këtu jo për të mirën e individit, por për të mirën e të gjithëve!

Është e vërtetë se në vitet e shkuara ne politikanët kemi pasur disa konflikte të ashpra. Por sot nuk do të flas për diskutimet e vogla a të mëdha. Qytetarët e FUTURA-s kanë përjetuar dhe parë nga afër paaftësinë e të zgjedhurve të tyre për të qeverisur!

Pas disa muajsh qytetarët do t’u drejtohen sërish kutive të votimit për të zgjedhur këshillin bashkiak, për t’i dhënë atij votëbesimin, për t’u angazhuar me vendimet dhe kompetencat e veta për të mirën e qytetit dhe për interesat e qytetarëve!

Por kësaj here ishin më të paktë ata qytetarë që ushtruan të drejtën e tyre të votës për të formësuar politikën në vend. Por çdo të ndodhë, nëse demokracia jonë e bazuar mbi logjikën një ditë prej ditësh humbet bazën e saj, popullin?!

Tani, në prag të fushatës zgjedhore, kryetari i bashkisë u nda nga jeta si pasojë e një aksidenti tragjik në shtëpinë e pushimit në bregdet. Bashkia dhe këshilli bashkiak janë të hidhëruar për këtë humbje të thellë.

E megjithatë duhen zgjidhur disa çështje formale. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi anëtarët e këshillit bashkiak duhet të zgjedhin nga radhët e tyre një kryetar bashkie për muajt në vijim.

Por asnjë prej partive politike të përfaqësuara këtu nuk ka shumicën, ndaj për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë është e nevojshme të gjendet dhe formohet një aleancë e qëndrueshme ndërmjet partive, një koalicion funksionues i disa partive.

Anëtarët e Këshillit Bashkiak e dinë mirë se vendimi për bashkëpunim në këtë moment përbën dhe një sinjal për zgjedhjet e ardhshme. Në këtë kuptim do të merren vendime të rëndësishme për të ardhmen e FUTURA-s, kryeqytetit të BONNIELAND-it.

Le të zgjedhim së bashku një njeri të nderuar nga radhët tona! Jo thjesht për hir të stabilitetit, por për hir të mirëqeverisjes në funksion të së ardhmes së qytetarëve tanë!

(Mund të shtohen edhe formulime personale!

Le të nisim pa humbur kohë seancën dhe mos harroni se jeni zgjedhur për të mirën e përbashkët të FUTURAS dhe të popullit!

Përshkrimi i roleve të grupeve të interesit

Si përfaqësuese dhe përfaqësues të një grupi interesi Ju i përdorni aftësitë tuaja për informimin e politikanëve dhe politikanëve të zgjedhur dhe për informimin e mediave. Ju nuk zgjidheni me zgjedhje publike. Por kjo nuk do të thotë, se kemi të bëjmë me mungesën e të drejtës demokratike për bashkëvendosje! Megjithatë, në demokracitë moderne u kushtohet shumë rëndësi informimit dhe pjesëmarrjes së eksperteve dhe ekspertëve dhe grupimeve sociale, të cilët, për arsye personale, aktivizohen në mënyrë aktive dhe/ose ofrojnë ekspertizën e tyre.

Ju angazhoheni në mënyrë që të ushtroni ndikim, sipas mendimit të juaj, tek politikanët/politikanet e zgjedhur/a dhe tek partitë! Vullneti i juaj është që te beni të qartë vendimmarrësve qëndrimin e juaj dhe te nxitni ata që të marrin vendime në favor të tyre.

Për këtë arsye ju flisni/Folni ? me partitë dhe deputetët e parlamentit për gjëra, që qëndrojnë afër pozicionit që e përfaqësoni.

Shprehni mendimin Tuaj! Bëjeni të qartë, se anëtarët e grupimit Tuaj e mbështesin partinë përkatëse, dhe se ata – si zgjedhës/zgjedhëse potencialë – mund të jenë shumë të zhgënjyer, nëse kjo parti nuk do të arrinte rezultatet në të mira që dëshirojnë ata. Duke qenë se politikanet dhe politikanët e zgjedhur janë të detyruar që të sigurojnë shumicën si për zbatimin e disa pozicioneve të caktuara, ashtu edhe për çështje që lidhen me postin e tyre, duhet që ata të negociojnë dhe mundësisht të jenë të gatshëm për të arritur kompromise! Në përgjithësi ata nuk kanë asgjë kundër kompromiseve. Por duke qenë se Ju përfaqësoni vetëm një pozicion të vetëm, atëherë Juve nuk ju duhet që të arrini apo propozoni kompromise. Ju përfaqësoni brenda grupimit Tuaj vetëm një mendim, dhe për këtë arsye shumë grupe lotimi quhen edhe „One-Topic-Groups“.

Sigurisht që Ju nuk do të flisni vetëm me politikanët/politikanet që mund t’Ju mbështesin potencialisht. Çfarë duhet bërë, nëse në fuqi është ajo parti, të cilët nuk e mbështesin anëtarët e saj? Anëtarët e saj duan që Ju të arrini më të mirën për veten dhe pozicionin Tuaj. Të gjithë politikanët/politikanet e zgjedhur/a duhet të informohen për pozicionin Tuaj! Ju jeni në kontakt të vazhdueshëm me mediat; nga njëra anë për të dhënë informacione, nga ana tjetër për të ushtruar presion nëpërmjet mediave. Dhe Ju nuk lini të humbasë asnjë rast për ta bindur publikun, se pozicioni që përfaqësoni Ju është më i miri për të ardhmen e FUTURAS!

Për ta fuqizuar më shumë pozicionin Tuaj, mund të jetë e dobishme, që Ju t’i njihni edhe qëndrimet e grupeve të tjera të interesit!

Sapo kryetari i ri i bashkisë të ketë marrë detyrën, paraqitini një kërkesë parlamentit të qytetit FUTURA, në mënyrë që të arrini synimin Tuaj.

Grupi i interesit: Bashkësia Budiste

Ju jeni zëdhënësi/zëdhënësja i/e bashkësisë. Bashkësia Juaj prej shumë vitesh është pjesë e FUTURAS dhe bashkësitë e tjera fetare Ju i konsideroni si miq të mirë! Anëtarët Tuaj janë njerëz normalë me interesa dhe mendime të ndryshme.

Duke qenë se dikur BONNIELAND-i, si shtet ateist, e kishte kufizuar ushtrimin e të drejtës fetare për anëtarët e organizatës Suaj dhe shumë besimtarë të besimeve të tjera fetare. JU tani ndodheni para një fillimi të ri me sfida të mëdha që duhen përballuar. Liria fetare është një nga elementet thelbësorë të shteteve moderne. Pikërisht, nisur nga kjo perspektivë historike, Ju përfaqësoni një grup të veçantë të popullsisë, i cili angazhohet për një BONNIELAND të fuqishëm, modern dhe të larmishëm.

Pluralizmi dhe larmia si edhe të drejtat e minoriteteve janë aspekte, të cilat janë të rëndësishme për Ju. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një jetë më e mirë në shoqëri.

Në fakt, Ju parimisht nuk jeni kundër përparimit dhe industrializimit, por megjithatë Ju njeriun e shikoni si një individ të papërsëritshëm dhe jo si një pjesë funksionale e një shoqërie, e cila ka për qëllim efikasitetin dhe maksimizimin e dobisë. Kjo Ju bën që të jeni një grup interesi i jashtëzakonshëm.

Por Ju keni një dëshirë të veçantë: një vend të ri për një tempull! Ju përpiqeni që kërkuat e Tuaja t'i realizoni në kuadër të bisedave me të gjitha bashkësitë dhe grupet e tjera të interesit.

Kërkesa e Komunitetit Budist Për Anetaret e bashkisë së FUTURës

Ne i kërkojmë Bashkisë të FUTURAS që sipërfaqet publike të tregut të madh në qendër të FUTURAS, që aktualisht përdoren si vendparkime, t'i vihen në dispozicion bashkësisë sonë për ndërtimin e një tempulli të ri.

Nga njëra anë qyteti do të përfitonte në zemër të tij një simbol arkitekturor, dhe nga ana tjetër industrisë së FUTURAS do t'i viheshin në dispozicion sipërfaqet e nevojshme për zgjerimin e aktivitetit.

Ne besojmë, se shoqëria e lirë dhe bashkëpunuese e FUTURAS pas shumë dekadash është e gatshme që t'i shohë të bashkuara në qendër të kryeqytetit grupimet e shumta fetare.

Ne jemi të gatshëm që sipërfaqen e "tempullit të vjetër" ta ofrojmë në këmbim të sipërfaqes së tregut të madh që aktualisht përdoret si sheshparkimi.

Grupi i interesit: Komuniteti i pronarëve të FUTURA-s

Ju personalisht posedoni një nga bizneset më të mira në FUTURA. Bizneset dhe një qendër e gjallë e qytetit janë sipas mendimit Tuaj gjëja më e rëndësishme për të ardhmen e BONNIELAND-it. Në këtë kuadër Ju jeni “zëri i të ardhmes”.

Në të shkuarën pronarët e bizneseve nuk kishin pothuajse asnjë mundësi që të ushtronin aktivitete tregtare. Në fakt në industri kishte ndërmarrje të mëdha, por ato ishin ndërmarrje shtetërore. Sipërmarrjet e mesme dhe të vogla ishin të ndaluara. Tregjet ishin të vegjël, ashtu siç i njohim ne sot në FUTURA dhe në bashki të tjera të BONNIELAND-it. Në rast se Ju kishit më shumë prona se “qytetari standard”, atëherë akuzoheshit për mashtrim ndaj shtetit, dhe se kishit krijuar kapital të shumtë në rrugë ilegale. Pikërisht nisur nga ky sfond historik, Ju keni një karakteristikë e re e kryeqytetit FUTURA si edhe e bashkive të tjera të BONNIELAND-it.

Duke qenë se Ju angazhoheni për një ekonomi të fortë dhe për interesat e saj, atëherë Ju do ta konsideroni si një pengesë fuqizimin e të drejtave të punëmarrësve. Ju nuk doni të humbisni të ardhurat. Një qendër e gjallëruar e qytetit me shumë biznese të vogla e nxit më shumë fuqinë blerëse, çka sipas mendimit Tuaj mund të krijojë më shumë vende pune.

Ju, si zëri i Komunitetit të Pronarëve, i paraqisni në plan të parë kërkesat , dhe i konsideroni si kërkesat më të rëndësishme të të gjitha grupeve të tjera të interesit, sepse Ju mendoni, se pa bizneset nuk mund të funksionojë asgjë.

Ju përpiqeni që kërkuat e Tuaja t’i realizoni në kuadër të bisedave me të gjitha bashkësitë dhe grupet e tjera të interesit.

Kërkesa e Komunitetit të Pronarëve të –FUTURA-s Për Anetaret e bashkisë së FUTURës

Bashkia e FUTURA-s është në konkurrencë të drejtpërdrejtë me qytetet e tjera të mëdha në këtë pjesë të Europës! Por këtu FUTURA le shumë për të dëshiruar!

FUTURA, qytetaret dhe qytetarët, investitorët dhe pronarët e bizneseve të së cilës kanë nevojë për një Qendër Tregtare, e cila mund të konkurrojë me qendrat tregtare të qyteteve të tjerë.

Bashkia duhet që sipërfaqet publike të tregut të madh, të cilat përdoren si sheshparkimi, t'i verë në dispozicion për ndërtimin e një qendre të re tregtare dhe moderne!

Bashkisë i nevojitet ky hap si shenjë e modernizmit dhe e rritjes!

Bashkia ka nevojë për një qendër të re tregtare me vende parkimi të integruara!

Qyteti ka nevojë për shumë vende të reja pune!

Sapo qeveria dhe parlamenti i FUTURAS të japin shenjën e fillimit për një të ardhme më të mirë, pronarët e bizneseve do të fillojnë menjëherë një fushatë mediatike!

Grupi i interesit: Grupimet ambientaliste „Shpëtoni vendin tonë BONNIELAND“

Ju jeni zëdhënësi/zëdhënësja e grupimeve ambientaliste.

Para 15 vitesh mbrojtja e mjedisit nuk luante asnjë rol në BONNIELAND. Aspekti mjedisor injorohej nga të gjithë faktorët politikë në të gjithë territorin. Për këtë arsye, Ju dhe shoqëria, ndodheni përpara sfidave të reja, të cilat janë shumë të rëndësishme për të garantuar edhe zhvillimin e qëndrueshëm për të ardhmen e BONNIELAND. Në këtë moment kërkohet vetëm angazhim.

Mjedisi është çështje e të gjithëve. Jo vetëm bukuria natyrore e BONNIELAND-it, por edhe shëndeti dhe mirëqenia janë shumë të rëndësishme për banorët, turistët dhe miqtë e BONNIELAND-it! Ju e kuptoni grupimin Tuaj si transmetues të zërit të atyre njerëzve, që duan të kenë një jetë të shëndetshme. Këtu nuk bëjnë pjesë vetëm aspektet e ndërtimeve në respekt të mjedisit, por edhe një bujqësi biologjike, ushqimi i shëndetshëm, energjia e përfituar nga era dhe uji si burime të reja për prodhimin e energjisë në të ardhmen dhe trajtimi i mjedisit në të gjitha aspektet në kuptim të qëndrueshmërisë.

Sa më i gjelbër të duket qyteti, aq më shumë Ju pëlqen Juve ai. Ju jeni kundër ndërtimit të parkingjeve dhe qendrave tregtare në qendër të qytetit, sa kohë që nuk ofrohet një balancim për natyrën dhe mjedisin.

Ju përpiqeni që kërkuat e Tuaja t'i realizoni në kuadër të bisedave me të gjitha bashkësitë dhe grupet e tjera të interesit.

Kërkesë e grupimeve ambientaliste „Shpëtoni vendin tonë BONNIELAND“ Për Anetaret e bashkisë së FUTURës

Prej 10 vjetësh grupimet ambientaliste të FUTURAS janë duke bashkëpunuar me moton: “Shpëtoni vendin tonë BONNIELAND”, në mënyrë që të përmirësojnë kushtet e shëndetit dhe jetës në kryeqytetin tonë!

Tani ka ardhur koha që ta shpëtojmë mjedisin edhe në pjesën tjetër të vendit për qytetarët dhe qytetarët tona!

Atraktiviteti i BONNIELAND-it është i njohur tashmë edhe jashtë Kontinentit, megjithatë mjedisi i ndotur i BONNIELAND-it është gjithashtu shumë i njohur!

Bashkësia duhet të miratojë planin për ta rikthyer natyrën në zemrën e qytetit! Për këtë qëllim duhet të rikthehet shtrati i lumit në gjendjen e tij natyrale dhe të krijohet një lidhje me pyllin!

Kjo jo vetëm do ta bënte përsëri tërheqës qytetin për njerëzit që banojnë në qendër, por edhe për qiradhënësit dhe pronarët e banesave, të cilët do t'i shikonin si fitimprurëse investimet në banesa; nga njëra anë duhet të shikohen efektet pozitive për familjet dhe nga ana tjetër efektet pozitive për bizneset, të cilët do të përfitonin gjithashtu nga rritja e konsumit të familjeve!

Në rast se FUTURA do ta humbasë edhe atë bukuri dhe natyrë që i ka mbetur, atëherë të gjitha çështjet që lidhen me të ardhmen e vendit nuk do të kenë asnjë vlerë!

Grupi i interesit: „Federata Industriale“ e FUTURA-s

Ju jeni Zedhenes ? Perfaqesues e “Federatës Industriale”! Industria prodhon pasuri, krijon vende pune dhe ofron fitime. Sipas mendimit Tuaj industria është fillimi i gjithçkaje.

Nëpërmjet ndalimit të lirisë së ushtrimit të profesionit dhe kufizimeve të mëdha të bizneseve private, BONNIELAND, në periudhën e shkuar, ka qenë shumë i izoluar nga shtetet e tjera. Në BONNIELAND as nuk bëhej fjalë për tregti globale. Edhe direktivat strikte të shtetit për shifrat e prodhimit dhe çmimet e prodhimit nuk sollën lulëzimin e ekonomisë. Izolimi dhe prapambetja ekonomike ishin pasojat negative të një represioni të fuqishëm dhe të kufizimit të lirive.

Ju jeni të gatshëm që kërkesat Tuaja t’i realizoni me të gjitha mjetet, sepse vetëm kështu, sipas mendimit Tuaj, do të ketë një shans për lulëzimin e FUTURAS dhe BONNIELAND-it.

Fuqizimin e të drejtave të punëdhënësve Ju e refuzoni në mënyrë kategorike, sepse kjo shkakton më shumë kosto dhe mundim për sipërmarrjet, çka do të sillte pasoja negative në ekonomi.

Ju përpiqeni që kërkuat e Tuaja t’i realizoni në kuadër të bisedave me të gjitha bashkësitë dhe grupet e tjera të interesit.

Kërkesë e „Federatës Industriale“ të FUTURA-s Për Anetaret e bashkisë së FUTURës

Ka shkuar dëm pothuajse një dekadë! Industria e FUTURAS ka nevojë urgjente për më shumë hapësirë për zgjerim dhe para së gjithash për të tërhequr investime të reja!

Zona e të ashtuquajturit “Tempulli i Vjetër” përshtatet shumë mirë për zgjerimin e zonës aktuale industriale! Bisedat midis Federatës Industriale dhe “Komunitetit Budist” do të kishin sjellë ndonjë përfundim, në rast se Parlamenti dhe Qeveria e FUTURAS do të kishin marrë vendimet e nevojshme!

FUTURA ka nevojë për një parlament bashkiak funksional, për një qeveri funksionale dhe për vendime të drejta!

Për industrinë taksapaguese,

Për vende të reja pune,

Për investime të reja!

Ne, Federata Industriale, kërkojmë sipërfaqe të reja, në mënyrë që të mund ta zgjerojmë industrinë! Në rast të kundërt, të gjithë planet për lulëzimin e të ardhmes së industrisë sonë do të dështojnë!

Qeveria duhet të veprojë!

Grupi i interesit: „Federata sportive FUTURA dhe BONNIELAND“

Ju jeni menaxher/e e „Federatës Sportive FUTURA dhe BONNIELAND“. Presidenti i BONNIELAND është anëtar i federatës suaj!

Pas kushteve shumë të këqija në komunizëm, tashmë edhe për sportin në BONNIELAND ka filluar një kapitull i ri. Tani është radha Juaj, që t’i jepni jetë këtij kapitulli, të krijoni strukturat dhe t’i zhvilloni ato.

Sporti është shumë i rëndësishëm për njerëzit! Ju e kuptoni federatën Tuaj si transmetues të zërit të sportdashësve!

Sidomos futbollit është një nga historitë e suksesit me rritjen më të shpejtë në sport. Ekipi kombëtar i BONNIELAND-it ka hyrë në histori gjatë kohëve të fundit me sukseset e tij.

Ju angazhoheni për të gjitha kërkesat politike, të cilat sipas mendimit Tuaj u japin më shumë mbështetje sportit, anëtarëve dhe fansave.

Sipërfaqe të gjelbra po, por të përdoren edhe nga sporti!

Ju përpiqeni që kërkuat e Tuaja t’i realizoni në kuadër të bisedave me të gjitha bashkësitë dhe grupet e tjera të interesit.

Kërkesa e „Federatës sportive FUTURA dhe BONNIELAND“ Për Anetaret e bashkisë së FUTURës

Bota ndërkombëtare e sportit i ka sytë nga FUTURA! Bota është duke pritur aplikimin e FUTURAS për t’u bërë organizatore e kampionatit të ardhshëm botëror të sportit!

Ne jemi të gatshëm për këtë aplikim, po ashtu edhe banorët e BONNIELAND-it dhe të gjithë fqinjët!

FUTURA duhet ta shfrytëzojë mirë këtë rast dhe të shndërrohet në qendrën e re moderne të sportit!

Për këtë qëllim duhet që parlamenti dhe qeveria t’i japin federatës sportive sipërfaqet e lira të tregut të madh, në mënyrë që të ndërtohet një stadium i ri dhe modern!

Në rast se FUTURA nuk e shfrytëzon këtë rast, nuk do ketë një mundësi të dytë!

Zgjedhësit/zgjedhëset janë fansa të sportit! Dhe fansat duan, që ne ta ndërtojmë këtë simbol të ri për të ardhmen e ndritshme të FUTURAS!

Hartë



Matrix

Koha	Partitë	Grupet e interesit	Shtypi
120 minuta	Udhëzimet për simulimin Rolet dhe rregullat Leximi		
60-90 minuta	Raund prezantimi për partitë Zgjedhja e një zëdhënësi Caktimi i një emri për partinë e përbashkët	Takimi brenda grupit të interesit Përcaktimi i qëllimeve dhe strategjive për implementimin	Krijimi i një gazete lajmesh
60 minuta	Takimi i partive dhe i përfaqësive të interesit Shkëmbimi i qëllimeve Ushtrimi i ndikimit nga ana e grupeve të interesit		Hulumtimi në bisedat e partive me grupet e interesit
60 minuta	Hartimi i programeve partiake Përgatitja e prezantimit të programeve në kuadër të një konference për shtyp	Përgatitja e prezantimit të programeve në kuadër të një konference për shtyp	Përgatitja e konferencës për shtyp
		Biseda individuale (paraprake) të grupeve të interesit me përfaqësues të shtypit	
30-45 minuta	Konferenca për shtyp		
30 minuta	Takime informale		
120 minuta	Ceremonia e hapjes – Mbledhja e parë e bashkisë Fjalimi i deputetit më të moshuar		
	Ftesë për bashkëpunim dhe biseda brenda	Ushtrimi i ndikimit nga ana e grupeve	Takimet e para me shtypin dhe artikujt e

	koalicionit	të interesit	gazetave Vëzhgimi i bisedave
30 minuta	Konferenca për shtyp		
90 minuta	Dy mbledhje të bashkisë Zgjedhja e kryetarit/kryetares së parlamentit të bashkisë		
	Mbledhja e parë e të bashkisë	Dorëzimi i peticioneve	Intervistat e para
30 minuta	Konferencë për shtyp		
30 minuta	Takime informale		
60 minuta	Përgatitja e kërkesave nga ana e partive dhe koalicioneve	Biseda me shtypin: Intervista dhe të reja	
30-60 minuta	Diskutim në Bashki Merren vendimet për kërkesat	Vëzhgimi i marrjes së vendimeve	
30-45 minuta	Konferencë për shtyp ose Talkshow		
60-90 minuta	Vlerësimi Përshtypje për simulimin, arritjet dhe pengesat		

Ngulit

© CIVIC GmbH – Institute for international education 2017

Publikimi bazohet ne „politics and bargaining- How to deal with Interests and Compromises?“ i cili u publikua nga bashkëpunimi me fondacionin Konrad Adenauer. Publikimi i vitit 2011, Shkupi (Maqedoni).